



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2303/2 prot

Datë 21.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-74541-07-07-2023, me objekt: Loti 3 “*Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II*”, me fond limit 83.333.333 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK, me NIPT K01730502Ë, me adresë: Rruga “Dituria”, Zona Kadastrale nr.8516, Nr. Pasurie 10/268, Lagja 14, Kodi Postar 2007, Shkozet, Durrës

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Tiranë

Në datën 20.09.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3434, si dhe nr. protokolli 2303/2023 datë 20.09.2023 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-74541-07-07-2023, me objekt: Loti 3 “*Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale ujësjellës kanalizime lëndë e parë Faza II*”, me fond limit 83.333.333 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur

nga operatori ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3434, si dhe nr. protokolli 2303/2023 datë 20.09.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik ofertues LIQENI VII nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të kualifikimit pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura me emërtim “Pune e ngjashme furnizime hidraulike 1, 2 dhe 3” gjykojmë se eksperiencat e mëparshme të këtij OE janë në fushën e punimeve ndërtimore dhe rrjedhimisht nuk plotësojnë kërkesën e kriterit 2.3.1 ku citohet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit

Faturat e paraqitura nga OE LIQENI VII nuk janë kontrata furnizime mallrash (lëndë e parë) me natyrë të ngjashme por janë kontrata punimesh ndërtimore me objekt:

- “Rikonstruksione ne rrjetin ekzistues te qytetit Durrës Zona 14”
- “Ndërtim KUN ne rrugën Shebeniku, Laknas L412 ml fi=315mm
- “Përmirësim i furnizimit me ujë lagja NR.1, Vadardhë, njësia administrative Sukth Bashkia Durrës” të cilat nuk përputhen me kërkesën e autoritetit kontraktor lidhur me këtë pikë.

Konkretisht, edhe pse kontratat e paraqitura nga ky operator si pune të ngjashme janë kontrata punimesh dhe jo kontrata furnizimesh, AK shqyrtoi vlerën e furnizimeve për keto kontrata dhe në përfundim vlerësoi se keto furnizime të cilat janë paraqitur dhe plotësojnë kriterin e afatit 3 vjeçar (gjatë tre viteve të fundit) nuk e arrijnë vlerën e 40% të fondit limit, sikurse percaktuar në pikën 2.3.1 të Dokumentave Standarte të tenderit (Loti 3).

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 21.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri